



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Kom.Dh.Shk.II.nr.61/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T. SH “M...” sh.p.k, me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.H, avokat nga Prizreni, kundër debitorit Auto shkolla “A...” me seli në Prizren, të cilin me autorizimin e përfaqëson B.M avokat nga Prizreni, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarës së kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.12/2020, të datës 25.01.2020, me datë **28.09.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit, N.T.SH “M...” shpk., me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.12/20, të datës 25.01.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.12/20, të datës 25.01.2020, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit Auto shkolla “A...”, me seli në Prizren, me pronar A.B, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.446/2019 të dt.03.12.2019 të Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani nga Prizreni, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim është shfuqizuar në tërësi derisa propozimi për përmbartim i kreditorës së përmbartimit N.T. SH “M...” shpk., me seli në Prizren, e që debitorja e përmbartimit Auto shkolla “A...”, me seli në Prizren me pronar A.B të detyrohet në pagimin e detyrimit në të holla në shumën prej 18,848.50€, që kërkohet nga dokumenti i besueshëm – Fatura, nr.00098/19 të datës 05.09.2019 në emër të qirasë e me kamatë ligjore prej 8% vjetore nga momenti kur është dashur ta paguaj faturën, refuzohet tërësisht si i pa bazuar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e përmbartimit në këtë çështje juridike të përmbartimit përveç së deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbartimit, të gjitha shpenzimet e përmbartimit do ti bartë pala e cila humb procesin gjyqësor-përmbartimor.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren PPP.nr.12/2020 i dt. 25.01.2020, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e të autorizuarës së kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, ku i njëjti ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozimin që të refuzohet në tërësi ankesa e kreditorit si e pabazuar dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren PPP.nr.12/2020 të datës 25.01.2020 të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkalles së Dytë, të Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarës së kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.T SH "M..." shpk., me seli në Prizren, me datën 03.12.2019 ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë në bazë të dokumentit të besueshëm dhe atë faturës nr.00098/2019, të datës 05.09.2019 në shumën e përgjithshme prej 18,848.50€ në emër të qirasë, me kamatë ligjore prej 8% nga momenti kur është dashur ta paguaj faturën, si dhe shpenzimeve të caktuara të përbarimit në shumën prej 94,40€.

Përbaruesi Privat Mehdi Reshani, me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin përbarimor P.nr.446/2019 të dt.03.12.2019, e ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 20.12.2019, ka ushtruar prapësim duke theksuar se për lokalin lëndor, i cili gjendet në qendrën tregtare në Ortakoll, e për të cilin kërkohet pagesa e qirasë, i njëjti është pronë e Komunës së Prizrenit dhe se debitori raportin kontraktual e ka ndërtuar me Komunën e Prizrenit, dhe së kanë obligim ndaj Komunës së Prizrenit dhe jo ndaj palës kreditore. Në këtë çështje nuk ka legjitimacion të dy palëve dhe së këtij prapësimi i ka bashkangjitur kontratën e qirasë që pala debitorë ka lidhur me Komunën e Prizrenit si person i trete.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 26.12.2019, duke theksuar se janë të pabazuara pretendimet e debitorit në prapësim, duke kërkuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi dhe Urdhëri përbarues privat P.nr.446/2019, të datës 03.12.2019 të mbetet në fuqi, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës së përbarimit në përputhje me numrin tarifor 9 të tarifës së Odes së Avokateve të Kosovës.

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.12/20, të datës 25.01.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe

e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.446/2019 të dt. 03.12.2019, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim të dokumenteve të besueshme, me tek ka arsyetuar se mbi çfarë baze juridike caktohet përmbarimi në një çështje juridike si dhe kushtet ligjore në të cilat mund të bëhet propozimi për përmbarim sipas dokumenteve të besueshme – faturave si në rastin konkret, ku baza ligjore është në nenin 21, 22, 29, 30, 37, 38, 40 dhe 43 të LPP –së. Gjykata Komerciale gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përmbarim ia ka bashkangjitur origjinalin e Faturës, nr. 00098/ 19 të datës 05.09.2019 për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 18,848.50€ në emër të qirasë e me kamatëvonesë prej 8% vjetore, po ashtu në këtë fature ceket afati për pagesën e detyrimit në të holla e qe është data 05.09.2019, e tërë kjo në bazë të nenit 30 të LPP-së, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 30 lidhur me nenin 37 të LPP-së që të veprohet sipas propozimit për përmbarim të palës kreditore e për realizimin e detyrimit të saj në të holla që e kërkon nga pala debitorë, derisa për prapësim si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbarimit, përcaktohet në nenin 67 dhe 69 të LPP-së, kurse shkaqet e parapara për prapësim përcaktohen në nenin 71 të LPK-së. Prandaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me faturën si dokument të besueshëm për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 18,848.50€.

Duke qenë se në rastin konkret ekziston njëri nga shkaqet që parashihet në nenin 30, 37 dhe nenin 71 të LPP –së, që ka të bëjë me përshtatshmërinë për përmbarim të faturave si dokumente të besueshme, gjykata e shkallës së parë gjeti se e njëjta faturë nuk i përmbanë të gjitha tiparet që të është e përmbarueshme, pra nuk i plotëson të gjitha kushtet ligjore që i parasheh neni 37 i LPP –së, e po ashtu fakti se në mes palëve në procedurë është kontestues së pala debitorë nuk ka kurrfarë raporti juridik me kreditoren, duke qenë se lokali lëndor i cili gjendet në ortakoll është pronë e Komunës së Prizrenit dhe se debitori është ne raport kontraktual me Komunën e Prizrenit, e mbi kete baze ka obligim ndaj Komunës së Prizrenit. Në këtë çështje juridike nuk ka legjitimacion pasiv dhe se në këtë fature edhe pse e pranuar pala debitorë këtë faturë nuk e ka nënshkruar. Mbi kete baze rezulton se pala kreditore sipas neni 71 par. 1 pika 6 të LPP-së, nuk është e autorizuar që pala debitorë t’ia kërkojë përmbarimin në bazë të faturës, si dokument i besueshëm pasi që pala debitorë nuk ka të nënshkruar ndonjë kontratë të qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist por edhe kontrata, nr.03/3-361-20/Ia e datës 15.02.2012 është e nënshkruar nga përfaqësuesi A.B “Zyra Administrative – A...” si qiramarrës dhe Komuna e Prizrenit, si qiradhënëse, mbi gjendjen e tillë fatura respektive i bënë të pa përshtatshme për përmbarim. Vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori konform neni 13 të LPP –së lidhur me nenin 450 të LPK –së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm,

për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin-faturë e cila nuk paraqet dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk derivon nga puna juridike, është panëshkruara nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se fatura është pranuar nga ana e debitorit, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se nuk është e nënshkruara nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së.

Po ashtu, kjo gjykate vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë kontestimore në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga fatura respektive , andaj në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, fatura si e tillë, është e pa përshtatshme për përbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të lartëcekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.61/22, me datë 28.09.2022

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**